



MIRATOHET

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

PAVLIN NDREU



DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

PLAN PËR BARAZINË GJINORE 2024-2025/6

Plani për Barazi Gjinore paraqet një dokument të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, me anë të të cilit konfirmojmë përkushtimin institucional për avancim të të drejtave për të gjithë punonjësit e institucionit tonë. Si një e drejtë themelore e çdo njeriu, barazia gjinore është synim prioritar edhe për institucionin tonë. Dedikimi ynë për ambient gjithëpërfshirës, për punonjësit dhe të gjithë bashkepunuesit tone, është i pamatshëm. DPD-ja, si autoriteti përgjegjës për funksionimin e administratës detare, për politikën e zhvillimit të transportit detar dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit për fushën e detarisë, me përpilimin dhe aprovimin e këtij plani, vazhdon të kontribuoj në çështje të rëndësishme si barazia gjinore

Plani i barazisë gjinore është një angazhim me kohështrirje të gjatë, i cili garanton fuqizimin e rolit koordinues e monitorues të mekanizmit të barazisë gjinore.

Parimet kryesore që udhëheqin këtë plan janë:

- Barazia gjinore, kusht për një shoqëri të drejtë, të qëndrueshme e socio-ekonomikisht të zhvilluar
- Ndjeshmëri dhe trajtim i barabartë ndaj nevojave të veçanta të të dyja gjinive
- Njohja, vlerësimi dhe respektimi i diversitetit
- Tolerancë zero kundrejt dhunës ndaj grave e dhunës në familje, koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional

Njohja dhe respektimi i të drejtave ligjore të barabarta ndërmjet grave dhe burrave theksohen që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 18/2 të së cilës promovohen parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet

padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale”.

Në përputhje me ligjin Nr.10109 datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës Së Shqipërisë” Urdhër Nr. 446, Datë 18.12.2019 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin Drejtorisë së Përgjithshme Detare” dhe detyrimit që buron nga Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 për Barazinë Gjinore në Shoqëri, Drejtoria e Përgjithshme ka hartuar Planin për Barazinë Gjinore i cili paraqitet si një dokument politikash përgjatë tri viteve të ardhshme, gjatë të cilave institucioni ynë synon të zbatojë veprime dhe projekte, për të reduktuar pabarazitë gjinore. Aktivitetet e planifikuara synojnë, nga njëra anë, të japin vazhdimësi dhe koherencë ndaj politikave ekzistuese nga institucioni dhe, nga ana tjetër, eksplorimin e veprimeve të reja, për të mbështetur adresimin e pengesave që ekzistojnë ende për barazinë gjinore.

Drejtorja e Përgjithshme Detare synon të krijojë një mjedis pune, me ç’rast të gjithë pa dallim gjinie të ndihen të pranuar dhe të vlerësuar. Ballafaqimi me diversitetin është vlerë dhe mundësi për të mësuar nga mendimet, përvojat dhe kompetencat e njëri-tjetrit.

1. Plani i Veprimit përmban 2 objektiva institucionale që synojnë:

- Krijimin e kulturës që promovon barazinë gjinore;
- Arritjen e balancës gjinore në pozita vendimmarrëse;

Metodologjia;

Në procesin e përpilimit të Planit të Barazisë Gjinore u konsultuan dhe u përdorën dokumentet/të dhënat e shënuara në vijim:

2. Kuadri ligjor vendore për barazi gjinore;

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030
- Kuadri ligjor ndërkombëtar për barazi gjinore¹ ;
- Kuadri ligjor i Drejtorisë së Përgjithshme Detare
- Horizon Europe Work Programme 2023-2024²;
- Statistikat për personelin e DPD;
- Materiale lidhur me praktikën e mira të publikuara në European Institute for Gender³

1. Vendim Nr. 400, Datë 30.6.2021 Për Miratimin E Strategjisë Kombëtare Për Barazinë Gjinore, 2021–2030, Dhe Të Planit Të Saj Të Veprimit
2. https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/docs/2021-2027/horizon/ep-call/2023-2024/ep-1-general-introduction_horizon-2023-2024_en.pdf
3. <https://eige.europa.eu/>

3. ANALIZA E SITUATËS

Barazia gjinore është e drejtë e ruajtur me ligj.

Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Nga vetë objekti i tij ligji rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës. Gjithashtu parashikohet mbledhja e detyrueshure e statistikave gjinore, nga të gjitha organet shtetërore, si dhe ngritja e strukturave dhe mekanizmave institucionalë për çuarjen përpara të barazisë gjinore. Plotësimi i kuadrit nënligjor për zbatimin e këtij ligji, ndër të tjera edhe me VKM Nr. 465 datë 16.07.2012 “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, i hapi rrugën jo vetëm planifikimit të objektivave të matshme gjinore në programet buxhetore të institucioneve qendrore, por edhe të gjitha hapave të mëtejshëm në drejtim të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor (BPGJ) në Shqipëri. Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri ka për qëllim të sigurojë barazi në të drejta dhe mundësi midis gjinisë mashkullore dhe femërore në të gjitha sferat e shoqërisë. Mbron dhe promovon të drejtat e grave dhe meshkujve në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, duke përfshirë të drejtat në punë, arsim, shëndetësi, dhe pjesëmarrje në jetën politike dhe shoqërore. Ligji ndalon diskriminimin bazuar në gjininë e një personi në çdo aspekt të jetës, duke përfshirë punën, shkollimin, dhe ndarjen e burimeve dhe shërbimeve publike, Ligji inkurajon promovimin e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e shoqërisë, duke përfshirë edukimin dhe sensibilizimin e publikut dhe veprimtaritë për të luftuar stereotipet gjinore dhe për të ndërmarrë masa për të përmirësuar pozitat e grave në shoqëri.

Ligji përcakton mekanizma për zbatimin dhe monitorimin e përpjekjeve për barazi gjinore, duke përfshirë themelimin e organeve dhe institucioneve specifike për këtë qëllim. Plani së bashku me objektivat institucionale, siç janë: krijimi i kulturës që promovon barazinë gjinore; arritja e balancës gjinore në pozita udhëheqëse; integrimi i perspektives gjinore në punë, etj ofron një rrugë të qartë për dy vitet në vijim, për orientim të aktiviteteve institucionale në drejtim të arritjes sa më të plotë të barazisë gjinore.

Përpjekjet në vazhdimësi për harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me atë ndërkombëtar, kanë rezultuar në evidentimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe luftës kundër diskriminimit gjinor, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, jo vetëm në ligje të veçanta dedikuara këtyre çështjeve, por edhe në legjislacionin shqiptar në tërësi.

3.1 Instrumente ndërkombëtarë

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality).
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPFA).
- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, etj.

3.2. Kuadri ligjor kombëtar

- Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligji Nr. 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar¹⁰.
- Ligji Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligji Nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
- Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Ligji Nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin”.
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”.
- Ligji Nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, si dhe me të gjithë ndryshimet e mëparshme që ka pësuar ligji bazë Nr. 9669/2006.
- Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”.
- Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”, etj.

3.3. Kuadri ligjor institucional

- Ligji nr.10109 datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës Së Shqipërisë”
- Urdhri Nr. 446, Datë 18.12.2019 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin Drejtorisë së Përgjithshme Detare”
- Urdhri e Kryeministrit Nr.49, datë 21.03.2024”Për një ndryshim në urdhrin nr. 139 datë miratimin e struktues dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare”,

- Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Dpdetare, nr. 157 , date 19.12.2023 “Për “Miratimin e Kodit të Etikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare”

Për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore, DPD-ja parasheh masa të përgjithshme dhe të veçanta.

Masat e përgjithshme përfshijnë detyrimet për analizën e statusit të femrave dhe meshkujve në institucion dhe fushat përkatëse; përfshirjen e integritit gjinor në të gjithë sektoret;

- sigurimin e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve në të gjitha konferencat, mbledhjet, seminarët dhe trajnimet jashtë dhe brenda vendit;
- caktimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe, projekte, trajnime dhe iniciativa për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e femrave;
- ndarjen sipas gjinisë të të gjitha të dhënave të nevojshme statistikore, që mbliidhen, regjistrohen, përpunohen dhe obligohen që këto të dhëna t'i dorëzojnë në Institucionet përgjegjëse

Plani i Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2025/6

Strategjia dhe Plani i Veprimit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare 2024-2025, i përpiluar në vitin 2024, synon të ketë ne vazhdimësi Burime edhe më të përkushtuara, për planin e barazisë gjinore, duke përfshirë angazhimin e burimeve njerzore dhe financiare dhe ekspertizës gjinore për ta zbatuar atë.

Objektivi 1: Rivendosja e burimeve njerzore dhe financiare:

Burime financiare: Drejtoria e Përgjithshme Detare angazhohet në PBA-në e vitit 2024-2026 të planifikojë një buxhet specifikisht të përcaktuar për zbatimin e planit për barazinë gjinore. Ky buxhet do të mbulojë shpenzimet si punësimi i ekspertëve, programet e trajnimit, fushatat e ndërgjegjësimit dhe çdo iniciativë tjetër që synon promovimin e barabartësisë gjinore.

Objektivi 2: Trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve njerzore:

Drejtoria e Përgjithshme Detare nëpërmjet Shkollës së Administratës Publike (ASPA) ka inkurajuar dhe ka bërë të mundur që punonjësit e saj të marrin pjesë në trajnimet për barazinë gjinore, diskriminimin etj. Janë afruar sesione trajnimi për anëtarët e stafit për të ngritur ndërgjegjësimin për çështjet gjinore, përparësitë dhe praktikën më të mira për promovimin e barabartësisë gjinore në vendin e punës.

Objektivi 4: Zhvillimi i politikave brenda institucionit:

Janë ndjekur dhe zbatuar politika që promovojnë barazinë gjinore dhe adresojnë çështje si rekrutimi, mbajtja, promovimi dhe pagesa e barabartë.

Objektivi 5: Trajtimi i punëmarrëseve / punëmarrësve pa diskriminim;

Marrja e masave të përkohshme dhe të veçanta nga punëdhënësi / punëdhënësjë, të cilat synojnë përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 9 të Kodit të Punës, si dhe ndërprerja e kësaj mase sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta; sigurimi nga punëdhënësi / punëdhënësjë i përshtatjes së arsyeshme të vendit të punës për

personat me aftësi të kufizuar ose persona të ndodhur në kushte të tjera; marrja e masave të nevojshme për të ndaluar ngacmimin moral të kryer prej punëdhënësit / punëdhënëses dhe nga punonjëset/punonjësit e tjerë, Inkurajimin pe punnjësve per denoncimin e rasteve mbi ngacmimin moral dhe seksual; etj

Objektivi 6: Programet e trajnimeve:

I është dhënë prioritet mbështetja dhe përparimi i karrierës së grave brenda institucioni dhe për t'u dhënë atyre qasje në drejtimin mundësisë për zhvillim profesional. Janë inkurajuar dhe mbështetur në marrjen pjesë aktive në projekte të Bashkimit European ku Drejtorja e Përgjithshme Detare është pjesë

Objektivi 7: Monitorimi dhe Vlerësimi:

Janë vendosur mekanizma për monitorimin e progresit: Indikatorët kryesorë të performancës dhe duke mbledhur të dhëna për përfaqësimin gjinor, barazinë në pagë, normat e promovimit dhe kënaqësinë e punonjësve përmes sondazheve dhe mekanizmave të tjera të komunikimit.

	Deri ne fund te vitit (2023)	
		Total
Te dhena te pergjithshme		
numri total i nepunesve civile gra, ne daten 31 dhjetor 2023		11
numri i nepunesve civile gra, te kategorise ekzekutive		8
numri i nepunesve civile gra, te kategorise se ulet dhe te mesme drejtuese, ne daten 31 dhjetor		3
numri i punonjesve gra me kontrate ne daten 31 dhjetor		3
numri i punonjesve burra kontrate ne daten 31 dhjetor		2
numri i nepunesve civile burra, te kategorise se ulet te mesme drejtuese dhe te larte deri me 31 dhjetor		11
numri i nepunesve civile burra, te kategorise ekzekutive ne daten 31 dhjetor		45